



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Drejtoria e Bujqësisë

**PÛRKRAHJA E FERMERËVE NË LËMIN E PRODHIMTARISË
ORGANIKE - BIMË MJEKUESE-AROMATIKE “GOJI BERRY”**

Qëllimi:

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të planit zhvillimor në lëmin e bujqësisë, rëndësi të veçantë i ka kushtuar përkrahjes së prodhimitarisë organike – bimë mjekuese dhe aromatike.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje, kultivimi i “Goji Berry”, mbjellja e sipërfaqeve me këtë kulturë është një ndër prioritetet, pasi që si bimë mjekuese karakterizohet me veti shëruese dhe me një levërdi ekonomike.

Kriteret :

- Përkrahen fermerët për mbjellje të sipërfaqes prej 0,25-0,50 ha;
- Përfituesi duhet të jetë banor, si edhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës;
- Fermerët janë të obliguar që ta bëjnë vet furnizimin me fidanë, si dhe mbjelljen e tyre në sipërfaqen e planifikuar;
- Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje me këtë kulturë, së paku tri vite nuk duhet të kenë qenë të mbjella me kultura konvencionale;
- Rimbursimi i mjeteve nga ana e Komunës për fermerët, do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara dhe varësisht nga numri i fidaneve të mbjellur;
- Fermerët duhet të furnizohen me fidanë nga entiteti i licencuar për prodhimin apo tregtimin e bimëve aromatike-mjekuese “Goji Berry” (hibrid);
- Fermerët e zgjedhurë janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do ta mbjellin me “Goji Berry” dhe nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e kësaj kulture, atëherë përfituesi/ja , do të refuzohet;
- Duhet të investojnë në vendosjen e sistemit të ujitjes pikë – pikë;

- Fermerët do të përkrahen për 500 - 1100 fidanë, varësisht nga madhësia e sipërfaqe së planifikuar për mbjellje;
- Vlera e përkrahjes do të jetë varësisht nga sipërfaqja e mbjellë;
- Çmimi i pranueshëm është 5,00 € / fidanë.
- Të gjitha transaksionet - pagesat duhet të realizohen nëpërmes sistemit bankar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarin bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluejtshme, me afat deri në një vit;
- Kopja e planit;
- Licenca e entitetit ku është furnizimi me fidanë;
- Fatura;
- Certifikata e origjinës së fidanëve;
- Certifikata fito-sanitare;
- Konfirmimi i transaksionit bankar.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.